

VENDIM
Nr. 850, datë 15.12.2006

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, DISA BASHKIVE, TË PRONAVE, QË JANË
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR.60, DATË 1.2.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR”**

(Ndryshuar me VKM nr. 250¹, datë 18.3.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 42 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin, në pronësi, disa bashkive, të pronave, që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të miratuara me vendimin nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, si më poshtë vijon:

a) Objekti me numër rendor 11 në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Shkodër, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror;

b) Objekti me numër rendor 14, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra ditore e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Lezhë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Lezhës;

c) Objekti me numër rendor 19, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Fier, të kalojë në pronësi të bashkisë së Fierit;

ç) Objekti me numër rendor 20, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për të moshuarit”, Gjirokastrë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Gjirokastrës;

d) Objekti me numër rendor 23, në formularin e inventarizimit të pronave të paluajtshme shtetërore, “Qendra e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, Vlorë, të kalojë në pronësi të bashkisë së Vlorës.

2. Pronat e përcaktuara në pikën 1, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me vendimin nr.60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave.

3. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, dhe shërbimi shoqëror, që ofrohet në to, të transferohen së bashku me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin dhe personelin.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 064, kap.1, artikulli 600, 601 e 602, të grupit 25, titulli 064, kap 5, artikulli 600 dhe 602, të buxhetit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, miratuar për

¹VKM nr. 250, datë 18.3.2015 në pikën 3 shprehet;

“ 3. Prona e përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror.”

vitin 2006, dhe, në vijim, sipas vitit buxhetor përkatës.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetarët e bashkive, të përmendura në pikën 1, dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha